



**KUVENDI**  
NR 2518 DATE 19.10.17

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA  
TIRANË

Nr. 9996 Prot.

*Y. Çekaj*  
Tiranë, më 19/10/2017

Lënda:

Dërgojmë kërkesë dhe relacion *Shoqerues*

*1 = materialit ku është në dispozicion autorëve të bashkëlit të republikës 1: dhe 2-4- Tahiri monjohet!  
2- Të ndalohet Tahiri për shpirtim të bashkëlit!  
3 Të ndalohet Tahiri për shpirtim të bashkëlit!  
14.10.17*

Drejtuar:

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bashkëngjitur shkresës, dërgojmë kërkesë për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë **Saimir TAHIRI**, si dhe relacionin përkatës të arsyetuar.

Duke ju falendëruar për bashkëpunimin

DREJTUESI I PROKURORISË

BESIM HAJDARMATAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA  
TIRANË

Nr 9906 Prot

Tiranë me 19.10.2017

**Lënda:** Kërkohet dhënia e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Saimir TAHIRI.

**Baza ligjore:** Neni 73/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.  
Neni 288 të Kodit të Procedurës Penale.  
Neni 285 i Ligjit Nr 35/2017.

**Drejtuar:** KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

*Të nderuar zonja e zotërinj deputetë!*

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë mbi bazën e informacioneve të bëra publike, ka regjistruar procedimin penal me Nr. 313, të vitit 2017, për kryerjen e veprës penale:

1. “Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,
2. “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

në ngarkim të shtetasit Saimir Tahiri, i biri i Bashkimit dhe i Luiza, lindur më 30.10.1979, në Tiranë dhe banues në Tiranë.

## **A. Rrethanat proceduriale**

Me datë 17.10.2017 në bazë të të dhënave të bëra publike Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë konform nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale i cili parashikon se ‘Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale’, ka regjistruar procedimin penal me Nr 313 të vitit 2017 për veprat penale të *“Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim*, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, *“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”*, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal,

në ngarkim të personit në hetim: Sajmir TAHIRI, i biri i Bashkim dhe i Luiza, i dtl 30.10.1979, banues në Tiranë dhe banues në Tiranë,

dhe për veprat penale të *“Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim*, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhe *“Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”*, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal,

për personat në hetim Mosisi Habilaj, i biri i Ciko dhe Zenepe, i dtl 18.01.1978, lindur dhe banues në Vlorë, Florian Habilaj, i biri i Ciko dhe i Zenepe, i dtl 10.11.1980, Artan Habilaj etj.

Në lidhje me këto fakte penale dhe për subjektet Moisi Habilaj, Florian Habilaj, Artan Habilaj, Armand Kocerri, etj, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është zhvilluar hetimi në rang të procedimeve penale me Nr 134 të vitit 2016 dhe 164 të vitit 2017.

Konform nenit 79 të Kodit të Procedurës Penale me datë 18.10.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë ka vendosur bashkimin e procedimeve penale me Nr 134 të vitit 2016, 164 të vitit 2017 dhe 313 të vitit 2017 në një procedim të vetëm dhe konkretisht procedimin penal me Nr 134 të vitit 2016.

Për hetimet që po zhvillohen në funksion të procedimit penal me Nr 134 të vitit 2016, për shkak të bashkimit të procedimeve rezulton të jetë shënuar emri i personit në hetim Saimir Tahiri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

*“Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim*, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhe *“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”*, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në rang të procedimeve të lidhura, është kompetente në ushtrimin e ndjekjes penale në raport me rastin konform parashikimeve ligjore të nenit 285 të Ligjit nr 35/2017.

## **B. Rrethanat e faktit**

Nga ana e autoriteteve italiane të drejtësisë është arrestuar personi në hetim Moisi Habilaj, etj, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të Trafikimi i narkotikëve, kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme në rang të grupit të strukturuar kriminal. Arrestimi i këtij shtetasi është bërë në funksion të hetimeve që autoritetet italiane të drejtësisë po zhvillojnë në lidhje me kapjen dhe sekuestrimin e sasisë prej 3.5 tonësh lëndë narkotike e llojit Cannabis Sativa. Nga hetimet rezulton se ky shtetas në bashkëpunim me persona të tjerë të cilët ushtrojnë funksione publike në Republikën e Shqipërisë ka arritur të trafikojë për jashtë shtetit me destinacion Italinë sasi të konsiderueshme lëndë narkotike.

Si rezultat i veprimeve hetimore të kryera është arritur të zbulohet se personi në hetim Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të policisë së shtetit ku si person i dyshuar është dhe ish Ministri i Brendshëm, personi në hetim Saimir Tahiri. Personi në hetim Moisi Habilaj në bashkëpunim me persona të tjerë duke përfutur nga lidhjet e ngushta me ish Ministrin e Brendshëm dhe kundrejt shëprblimeve kanë arritur të bëjnë të mundur kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike, transportimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit. Në dijeni të këtyre detajeve dhe me veprime aktive dyshohet të ketë vepruar dhe ish Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, i cili ka siguruar paprekshmërinë e veprimtarisë kriminale të grupit të strukturuar kriminal.

E gjithë veprimtaria kriminale mbështetet në bashkëpunimin e grupit kriminal me strukturat e policisë së shtetit, ku përfitimet direkte monetare shkonin tek ish Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri.

**Nga veprimet e deritanishme hetimore të kryera rezulton se:**

- Është kapur dhe sekuestruar një sasi e konsiderueshme lëndë narkotike, në masën prej rreth 3.5 ton lëndë narkotike e llojit Cannabis Sativa nga autoritetet italiane të drejtësisë të dyshuara si të trafikuar nga grupi kriminal Moisi Habilaj etj.
- Me datë 18.10.2017 është kapur dhe sekuestruar një sasi lëndë narkotike prej 3.978 ton (tre tonë e 978 nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë kg), e llojit Cannabis Sativa, në banesën e shtetasit në hetim Armand Koçerri, bashkëpunëtor i shtetasve Moisi Habilaj, Florjan Habilaj etj.
- Subjektet e dyshuara Moisi Habilaj etj, në komunikimet telefonike dhe bisedat ambientale që rezultojnë nga përgjimet e bëra ndërmejt tyre rezulton të pasqyrojnë detaje të cilat tregojnë përfshirjen në veprimtarinë kriminale të shtetasit në hetim Saimir Tahiri.
- Subjektet e dyshuara Moisi Habilaj etj, në komunikimet e bëra ndërmejt tyre rezulton të pasqyrojnë detaje të cilat tregojnë shpërblimet që i japin ish Ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri në funksion të realizimit të veprimtarisë së tyre.
- Subjekti në hetim Saimir Tahiri me datë 05.11.2013 ka realizuar shitjen e automjetit me targa AA003GB, tek personi në hetim Artan Habilaj, vëllai i të arrestuarit Moisi Habilaj.
- Me datë 16.08.2014, 30.08.2014, 29.08.2014, 08.08.2014, personi në hetim Saimir Tahiri udhëton dhe përdor mjetin me targa AA003GB, i cili sipas aktit të shitjes rezulton të jetë shitur me datë 05.11.2013. Në këto udhëtime rezulton që personi në hetim Saimir Tahiri ka qënë i shoqëruar nga subjektet e tjera të dyshuara Artan Habilaj, etj.

Nisur nga sa më sipër, në kushtet e sekuestrimit të lëndës narkotike, dhënies së shpërblimeve nga grupi kriminal funksionarëve të lartë zyrtarë, mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme me ish Ministrin e Brendshëm Saimir Tahiri, ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprimtarisë kriminale dhe përfshirjes në këtë veprimtari të të dyshuarit Saimir Tahiri.

Nga detajet e analizuara ka dyshime se ndodhemi para elementëve të figurave të veprave penale të “*Trafikimi i narkotikëve*” kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të

strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga nenet 260 të Kodit Penal, dhe “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga nenet 245 i Kodit Penal, për të cilat është në hetim shtetasi Saimir Tahiri, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për nenet 283/a/2, 333/a dhe 260 të Kodit Penal.

Në këto kushte është e domosdoshme që në kuadër të ushtrimit të ndjekjes penale, dhe kur shihet e nevojshme që ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg, ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, konform nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi.

Për sa më sipër, ju drejtohem me këtë kërkesë me objekt dhënia e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Saimir TAHIRI.

***Të nderuar zj./z. Deputetë!***

Me qëllim për t’i hapur rrugë një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm nga ana e Prokurorisë, bazuar në nenet 73/2 të Kushtetutës së RSH-së dhe 288 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, kërkojmë nga Ju dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollin personal ose të banesës, së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, shtetasit Saimir TAHIRI.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**BESIM HAJDARMATAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA  
TIRANË

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë me 19.10.2017

**Lenda:** Dërgohet relacion shoqërues lidhur me kërkesën drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për dhënien e autorizimit, për arrestimin ose heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe të banesës së deputetit Saimir Tahiri.

**Drejtuar:** KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**TIRANË**

*Të nderuar zonja e zotërinj deputetë!*

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me datë 19.10.2017 ka kërkuar nga Kuvendi i RSH-së, dhënien e autorizimit sipas kërkesës së paraqitur në lëndë.

Deputeti Saimir Tahiri dyshohet se ka konsumuar elementë të veprave penale të mëposhtme:

1. "Trafikimi i narkotikëve" kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,
2. "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

**A. Rrethanat e faktit**

Me datë 17.10.2017 në bazë të të dhënave të bëra publike Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë konform nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale i cili parashikon se 'Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale', ka regjistruar procedimin penal me Nr 313

të vitit 2017 për veprat penale të *“Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim*, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, *“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”*, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, në ngarkim të personit në hetim: Saimir Tahiri, i biri i Bashkim dhe i Luiza, i dtl 30.10.1979, banues në Tiranë dhe banues në Tiranë,

dhe për veprat penale të *“Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim*, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a dhe Korrupsioni aktiv i zyrtarëve të lartë ose i të zgjedhurve vendorë, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, për personat në hetim Mosisi Habilaj, i biri i Ciko dhe Zenepe, i dtl 18.01.1978, lindur dhe banues në Vlorë, Florian Habilaj, i biri i Ciko dhe i Zenepe, i dtl 10.11.1980, Artan Habilaj etj.

Në lidhje me këto fakte penale dhe në lidhje me subjektet Moisi Habilaj, Florian Habilaj, Artan Habilaj, Armand Kocerri, etj, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është zhvilluar hetimi në rang të procedimeve penale me Nr 134 të vitit 2016 dhe 164 të vitit 2017.

Konform nenit 79 të Kodit të Procedurës Penale me datë 18.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë ka vendosur bashkimin e procedimeve penale me Nr 134 të vitit 2016, 164 të vitit 2017 dhe 313 të vitit 2017 në një procedim të vetëm dhe konkretisht procedimin penal me Nr 134 të vitit 2016.

Për hetimet që po zhvillohen në funksion të procedimit penal me Nr 134 të vitit 2016, për shkak të bashkimit të procedimeve rezulton të jetë shënuar emri i personit në hetim Saimir Tahiri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të:

- *“Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim*, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,
- dhe *“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”*, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në rang të procedimeve të lidhura, është kompetente në ushtrimin e ndjekjes penale në raport me rastin konform parashikimeve ligjore të nenit 285 të Ligjit 35/2017.



Nga ana e autoriteteve italiane të drejtësisë është arrestuar personi në hetim Moisi Habilaj, etj, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të Trafikimi i narkotikëve, kryer në bashkëpunim, në formë të posacme në rang të grupit të strukturuar kriminal. Arrestimi i këtij shtetasi është bërë në funksion të hetimeve që autoritetet italiane të drejtësisë po zhvillojnë në lidhje me kapjen dhe sekuestrimin e sasisë prej 3.5 tonësh lëndë narkotike e llojit Cannabis Sativa. Nga hetimet rezulton se ky shtetas në bashkëpunim me persona të tjerë të cilët ushtrojnë funksione publike në Republikën e Shqipërisë ka arritur të trafikojë për jashtë shtetit me destinacion Italinë sasi të konsiderueshme lëndë narkotike.

Si rezultat i veprimeve hetimore të kryera është arritur të zbulohet se personi në hetim Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të policisë së shtetit ku si person i dyshuar është dhe ish Ministri i Brendshëm, personi në hetim Saimir Tahiri. Personi në hetim Moisi Habilaj në bashkëpunim me persona të tjerë duke përfituar nga lidhjet e ngushta me ish Ministrin e Brendshëm dhe kundrejt shpërblimeve kanë arritur të bëjnë të mundur kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike, transportimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit. Në dijeni të këtyre detajeve dhe me veprime aktive dyshohet të ketë vepruar dhe ish Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, i cili ka siguruar paprekshmërinë e veprimtarisë kriminale të grupit të strukturuar kriminal dhe sigurinë e kultivimit dhe të kalimit të sasive të konsiderueshme të lëndëve narkotike.

E gjithë veprimtaria kriminale mbështetej në bashkëpunimin e grupit kriminal me strukturat e policisë së shtetit, ku përfitimet direkte monetare shkonin tek ish Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri.

**Nga veprimet e deritanishme hetimore të kryera rezulton se:**

- Është kapur dhe sekuestruar një sasi e konsiderueshme lëndë narkotike, në masën prej rreth 3.5 ton lëndë narkotike e llojit Cannabis Sativa nga autoritet italiane të drejtësisë të dyshuara si të trafikuar nga grupi kriminal Moisi Habilaj etj. (të dhëna të ardhura në përgjigje të kërkesës për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve italiane të drejtësisë).
- Me datë 18.10.2017 është kapur dhe sekuestruar një sasi lëndë narkotike prej 3.978 ton (tre tonë e 978 nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë kg), e llojit Cannabis Sativa, në banesën e shtetasit në hetim Armand Koçerri, bashkëpunëtor i shtetasve Moisi Habilaj, Florjan Habilaj, artan Habila etj.

- Subjektet e dyshuara Moisi Habilaj etj, në komunikimet telefonike dhe bisedat ambientale që rezultojnë nga përgjimet e bëra ndërmejt tyre rezultojn të pasqyrojnë detaje të cilat tregojnë përfshirjen në veprimtarinë kriminale të shtetasit në hetim Saimir Tahiri. (të dhëna të ardhura në përgjigje të kërkesës për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve italiane të drejtësisë).
- Subjektet e dyshuara Moisi Habilaj etj, në komunikimet e bëra ndërmejt tyre rezultojn të pasqyrojnë detaje të cilat tregojnë shpërblimet që i japin ish Ministrin të Brendshëm Saimir Tahiri në funksion të realizimit të veprimtarisë së tyre.
- Subjekti në hetim Saimir Tahiri me datë 05.11.2013 ka realizuar shitjen e automjetit me targa AA003GB, tek personi në hetim Artan Habilaj, vëllai i të arrestuarit Moisi Habilaj. (akte të administruara nga hetimi, procesverbal për kqyrje dhe marrje prove materiale të kontratës së shitjes së datës 05.11.2013).
- Me datë 16.08.2014, 30.08.2014, 29.08.2014, 08.08.2014, personi në hetim Saimir Tahiri udhëton dhe përdor mjetin me targa AA003GB, i cili sipas aktit të shitjes rezultojn të jetë shitur me datë 05.11.2013. Në këto udhëtime rezultojn që personi në hetim Saimir Tahiri ka qënë i shoqëruar nga subjektet e tjera të dyshuara Artan Habilaj, etj. (të dhënat e përfutura nga kqyrja e sistemit TIMS, për lëvizjet për dhe nga jashtë shtetit të personit në hetim Saimir Tahiri, procesverbalet e kqyrjes).

Nisur nga sa më sipër, në kushtet e sekuestrimit të lëndës narkotike, dhënies së shpërblimeve nga grupi kriminal funksionarëve të lartë zyrtarë, mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme me ish Ministrin e Brendshëm Saimir Tahiri, ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprimtarisë kriminale dhe përfshirjes në këtë veprimtari të të dyshuarit Saimir Tahiri.

Nga detajet e analizuar ka dyshime se ndodhemi para elementëve të figurave të veprave penale të “*Trafikimi i narkotikëve kryer në bashkëpunim*”, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, parashikuar nga nenet 260 të Kodit Penal, dhe “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, parashikuar nga nenet 245 i Kodit Penal, për të cilat është në hetim shtetasi Saimir Tahiri, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për nenet 283/a/2, 333/a dhe 260 të Kodit Penal.

Nga të dhënat e hetimit të deritanishem, provat që ka në dispozicion organi procedues, ka dyshime të arsyeshme që personi në hetim Saimir Tahiri të ketë kryer veprë penale.

Në këto kushte, ekziston dyshimi i arsyeshëm se deputeti Saimir Tahiri ka konsumuar elementë të veprave penale:

1. "Trafikimi i narkotikëve" kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 333/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,
2. "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

**Në aplikim të nenit 228 të K.Pr.Penale masat e sigurimit mund të caktohen vetëm :**

- nesë në ngarkim të tij ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.
- kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;
- kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;
- kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Sipas parashikimeve të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, masat e sigurimit vendosen në raport me rëndësinë e faktit dhe sanksionet që parashikon vepra penale për të cilën dyshohet, respektivisht nenet 283/a/2, 333/a dhe 260 të Kodit Penal.

Rrezikshmëria shoqërore e këtij personi, duke marrë parasysh pozicionin që ai mban si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në raport me publikun dhe me institucionet ndërkombëtare, është tejet e lartë, duke iu referuar veprimeve të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme.

Bazuar në nenin 202, 204, 205, 289 të Kodit të Procedurës Penale, dyshohet se ky shtetas mund të ketë të fshehura në banesë apo ambiente të tjera, të cilat i frekuentojn, sende apo prova që janë të lidhura drejtëpërdrejtë apo tërthorazi me veprat penale, për të cilat po hetohet. Në rast se këto sende do të gjenden në disponim të këtij shtetasi ose në ambjentet e

kontrolluara, do t'i nënshtrohen sekuestrimit sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Krahas rrezikshmërisë shoqërore së veprave të paraqitura më lart, hetimi i këtij rasti vlerësojmë se ka një rëndësi specifike, ndër të tjera, edhe për imazhin e institucioneve shqiptare përballë opinionit publik dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, për të cilët Prokuroria ka paraqitur kërkesën për autorizim për arrestim, heqje lirie dhe kontroll personal dhe banese, vlerësojmë se me veprimet e tij të dyshuara, ka cënuar imazhin e institucionit ku ushtron funksionet e tij, si edhe të autoriteteve shqiptare në përgjithësi. Për këtë arsye, e konsiderojmë të nevojshme që Kuvendi i Shqipërisë të mbështesë kërkesën e Prokurorisë, për të dëshmuar para opinionit publik vendas dhe partnerëve ndërkombëtarë se forca e ligjit është njëlloj për të gjithë personat që kryejnë vepra penale.

Për sa më sipër, me qëllim për t'i hapur rrugë një hetimi të plotë dhe të gjithashëm nga Prokurori, bazuar në nenet 73/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë nga Kuvendi autorizimin për arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe për të ushtruar kontroll personal dhe të banesave të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Saimir Tahiri.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

**DREJTUESI I PROKURORISË**

